

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6525
E mërkurë, 2 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Kosova regjistron gjashtë viktima nga Covidi dhe mbi 2 mijë raste të reja



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR DHE PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BE-SË PËR DIALOGUN, MIROSLAV LAJÇAK, KANË VAZHDUAR VIZITËN NË KOSOVË

OPOZITA: MARRËVESHJA TA SIGUROJË NJOHJEN NGA SERBIA PA CENUAR SOVRANITETIN



Partitë opozitare i kanë dhënë mbështetje procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Pas takimit me përfaqësuesin e posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, lideri i PDK-së, ai i LDK-së dhe ai i AAK-së kanë shprehur qëndrime të njëjta. Ata kanë vlerësuar se marrëveshja me Serbinë duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë dhe në kufijtë ekzistues të Republikës së Kosovës

AKTUALE



HOVENIER: SHBA-ja DHE KOSOVA, TË PËRKUSHTUARA PËR TA MBËSHETUR UKRAINËN

KOSOVA DHE ZVICRA FILLOJNË BASHKËPUNIMIN PËR PËRGATITJEN PROFESIONALE TË MJEKËVE TË RINJ

RIHAPET QENDRA E MJEKËSISË FAMILJARE NË LIKOC



EKONOMI



PROJEKTLIGJI PËR TURIZMIN VLERËSOHET I NJË RËNDËSIE SHUMË TË VEÇANTË

SPORT



SOT DY NDESHJE NË LIGËN UNIKE

Qeveria i propozon ZRRE-së që blloktarifa të jetë 1 000 kWh e jo 600 kWh



2 SHKURT 1990: DITA E FILLIMIT TË PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

F. 10

Gjykata Kushtetuese nis shqyrtimin e shkarkimit të presidentit Meta

TIRANË, 1 SHKURT - Gjykata Kushtetuese në Shqipëri nisi të martën një seancë publike si pjesë e procesit të nisur për shqyrtimin e vendimit të Kuvendit për shkarkimin e presidentit Ilir Meta, të cilin shumica socialiste e akuzoi për shkelje të rënda të Kushtetutës dhe se u përfshi duke u bërë palë në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit.

Meta, siç dhe kishte paralajmëruar, nuk është paraqitur për të marrë pjesë, duke u përfaqësuar nga këshilltari i tij ligjor.

Gjatë seancës mbajtur të martën, përfaqësuesi i presidentit Bledar Dervishaj paraqiti një kërkesë parapake, sipas së cilës, secili prej anëtarëve të gjykatës duhet ta shqyrtonte mundësinë e dorëheqjes.

Dervishaj renditi një seri faktesh dhe rrethanash që, sipas tij, vënë në dyshim paanësinë e trupës gjyqësore dhe gjykimin me objektivitet të çështjes. "Presidenti ka humbur tërësisht besimin te kjo trupë, e cila nuk garanton procesin e rregullt ligjor dhe as paanshmërinë e saj", u shpreh Dervishaj, duke saktësuar që nëse kërkesa për dorëheqje nuk do të merrej në konsideratë, atëherë ai kërkonte përjashtimin e të gjithë trupës.

Përfaqësuesja e parlamentit, si palë në proces, e konsideroi

"abuzive" kërkesën e përfaqësuesit të Kreut të Shtetit, duke theksuar se qëllimi i vetëm sipas saj, është zvarritja e procesit. Ajo kërkoi rrezimin e kërkesës. Më pas trupa e gjyqtarëve u tërhoq për të marrë vendim lidhur me kërkesën e presidentit.

Që pas qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, për të mos u shprehur me një vendim lidhur me zgjedhjet vendore të 30 qershorit, "për moskompetencë" në trajtimin e një çështjeje të tillë, ai ka shprehur haptazi mosbesimin ndaj trupës së kësaj gjykate.

Javën e shkuar Kreu i Shtetit i kërkoi zyrtarisht Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nisjen e një procedimi disiplinor ndaj anëtares Fiona Papajorgji, duke ngritur dyshime për "shkelje të procedurave ligjore" për caktimin e saj si relatores e çështjes, si dhe duke e akuzuar se kishte shmangur pyetjet e ngritura nga Shoqata e Bashkive, në kërkesën për Opinion drejtuar Komisionit të Venecias.

Pak ditë më parë ai iu drejtua me një letër gjykatës, ku me tone kritike ngrinte shqetësimin për mungesë informacioni dhe transparence nga ky institucion, i cili, sipas tij, nuk u është përgjigjur të paktën dy shkresave zyrtare të tij.

Po ashtu, Meta kërkonte që



përfaqësuesit të tij t'i lihej në dispozicion një kohë e pakufizuar, ndryshe nga sa i është bërë me dije se do të mund të ketë vetëm një hapësirë 60-minutëshe, sipas rregullores së Gjykatës.

Kjo rregullore, vinte në dukje kreu i Shtetit, kishte hyrë në fuqi më 27 janar të këtij viti, pasi atij i ishte komunikuar ky afat kohor për mbrojtjen.

Nisma e shumicës për shkarkimin e presidentit Meta u vu në lëvizje pak ditë pas zgjedhjeve parlamentare, duke

vlerësuar se ai kishte shkelur rëndë Kushtetutën para dhe gjatë procesit zgjedhor, "duke u bërë palë me opozitën apo duke nxitur gjuhën e urrejtjes dhe të dhunës". Shumica veprroi me ngut për ngritjen e komisionit hetimor, që do ta vlerësonte kërkesën për shkarkim të firmosur nga deputetët e saj, duke qenë se miratimi në seancë do të duhej të bëhej brenda datës 9 maj, afati i fundit i lejuar nga ligji, kur parlamenti është në mbyllje të mandatit të tij.

Gjithçka u realizua në nxitim e

sipër, pa bërë kujdes as në respektimin e procedurave. Komisioni i ligjeve aprovoi menjëherë kërkesën dhe një ditë më pas, më 7 maj, parlamenti votoi në favor.

Presidenti Meta foli për "vendime apo veprimtari antikushtetuese dhe antiligjore të Kuvendit njëpartiak në detyrë", të cilat, siç theksoi, nuk do t'i njihje. Ai nuk u paraqiti në komisionin hetimor, i cili mbylli gjithçka për tri javë. Më 9 qershor parlamenti votoi në favor të shkarkimit (104 deputetë për, 7 kundër).

Zelenskiy u bënë thirrje ukrainasve të qëndrojnë të qetë



KIEV, 1 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, u ka bërë thirrje qytetarëve që të qëndrojnë të qetë dhe të bashkohen, derisa qeveria dhe liderë në mbarë botën po vazhdojnë përpjekjet për të shmangur një pushtim të mundshëm nga Rusia, e cila ka grumbulluar dhjetëra mijëra ushtarë përgjatë kufirit.

Duke folur në parlament, Zelenskiy tha të martën se "askush nuk po vendos për fatin e Ukrainës pas shpinës sonë", duke shtuar se ai shpreson se së shpejti do të vendoset data e

takimit të ardhshëm të grupit të Formatit të Normandisë që përfshin Ukrainën, Rusinë, Francën dhe Gjermaninë - për të diskutuar për zgjidhjen e tensioneve në rritje ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë.

"Ne po punojmë në mënyrë aktive për të vendosur sa më shpejt datën e takimit të ardhshëm të këshilltarëve në Berlin dhe shpresoj se do të arrihet një marrëveshje për takimin e liderëve të Formatit të Normandisë", tha Zelenskiy pasi nënshkroi një dekret për ta rritur numrin e forcave

ushtarake të Ukrainës për 100 mijë trupa për tre vjet dhe për të rritur pagat e ushtarëve.

Zelenskiy tha se ai ka zhvilluar bisedime me përfaqësues të 80 vendeve dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët, sipas tij, kanë mbështetur Ukrainën në përplasjen e vazhdueshme me Rusinë.

Moska ka mbështetur separatistët në luftën në lindje të Ukrainës, e cila ka marrë jetën e më shumë se 13 200 personave prej vitit 2014, vitin e njëjtë kur Rusia ka aneksuar Krimenë.

Danimarka heq të gjitha kufizimet kundër Covid-19

KOPENHAGË, 1 SHKURT - Danimarka u bë shteti i parë i Bashkimit Evropian që më 1 shkurt hoqi të gjitha kufizimet e vendosura kundër koronavirusit, pavarësisht prej numrit rekord të rasteve të shkarkuara nga varianti Omicron. Ky shtet skandinav edhe një herë po heq

masën e mbajtjes së maskave, certifikatën e vaksinës, kufizimin e punës së bareve dhe restoranteve. Danimarka kishte bërë një eksperiment duke hequr të gjitha kufizimet edhe në periudhën shtator-nëntor të vitit të kaluar.

Klubet e natës do të rihapen më

1 shtator dhe, po ashtu, numër i pakufizuar i njerëzve mund të marrin pjesë në grumbullime në ambiente të mbyllura.

Vetëm disa kufizime do të jenë në fuqi në kufijtë shtetërorë për udhëtarët e pavaksinuar që vijnë nga shtetet që nuk janë në Zonën Shengen.



2 shkurt 1990: Dita e fillimit të pajtimit të gjaqeve në Kosovë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 SHKURT - Si zakonisht, në rastet e shtypjes me dhunë të demonstratave të shqiptarëve të Kosovës, regjimi pushtues i Beogradit përmes manovrimeve të ndryshme politike, diplomatike dhe propagandistike, në janarin e vitit 1990 përpqej ta demantonte dhunën e përdorur publikisht dhe vrasjen e demonstruesve paqësorë shqiptarë në Kosovë nga forcat e tij speciale policore. Krerë të caktuar ushtarakë dhe politikë të këtij regjimi, në mesin e tyre edhe Ali Shukria, përmes medieeve elektronike dhe të shkruara, që kontrolloheshin nga pushteti, përpqeshin që t'i përgënjeshtroin aktet e vrasjeve para opinionit, duke deklaruar publikisht se "nuk janë forcat policore të regjimit ato që po kryejnë vrasjet e demonstruesve në Kosovë", por "vrasjet i bëjnë vetë shqiptarët sipas ligjeve të Kanunit të Lekë Dukagjinit". Sipas këtyre tellallëve të Beogradit, vrasjet e demonstruesve s'ishin gjë tjetër veçse marrje e hakut nga shqiptarët e hasmëruar me njëri-tjetrin që prej vitesh, të cilët për këtë qëllim tashmë po shfrytëzonin "trazirat" e filluara gjithandej Kosovës. Pikërisht rreth këtij "argumenti" të regjimit kolonial të Beogradit është hapur biseda në takimin e rastësishëm në një rrugë të Pejës, tani quhet rruga "Lidhja e Pejës", qytetit më verior i Rrafshit të Dukagjinit, ku po prisnin të luante nga vendi një

autobлиндë policie që kishte bllokuar hyrjen në qendër të qytetit, në mes të ish-të burgosurve politikë Have Shala, Myrvete Dreshaj, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj. Aty, në atë rrugë që të çon në sheshin para Shtëpisë së Mallrave, Have Shala shtron idenë e fillimit të pajtimit të familjeve të hasmëruara, ide të cilën më herët e kishte biseduar me shogën e saj të shkollës së mesme dhe pastaj edhe me grupin politik dhe të burgut, Myrvete Dreshaj. Për të biseduar nismën konkrete dhe realizimin e saj, ata vendosin për t'u takuar në mbrëmjen e po asaj dite në shtëpinë e ish-të burgosurit politik Adem Grabovci. Ideja për t'u takuar në shtëpinë e tij dhe për ta diskutuar idenë për pajtimin e gjaqeve ishte dhënë nga Lulëzim Etemaj.

Sipas marrëveshjes paraprake, në takim në shtëpinë e Adem Grabovcit, në periferi të qytetit të Pejës, kanë marrë pjesë Have Shala, ish-e burgosur politike, studente, me vendbanim në fshatin Rashi, komuna e Pejës; Myrvete Dreshaj, ish-e burgosur politike, studente, nga fshati Vrellë, komuna e Istogut, me vendbanim në Pejë; Adem Grabovci, ish-i burgosur politik dy herë radhazi, student, me studime të ndërprera për shkak të burgosjeve, me prejardhje nga fshati Saradran, komuna e Istogut, me vendbanim në Pejë; Lulëzim Etemaj, ish-i burgosur politik, student, me vendbanim në fshatin Saradran, po ashtu komuna e Istogut, si dhe



Brahim Dreshaj, ish-i burgosur politik, student, me vendbanim në fshatin Nabërgjan, komuna e Pejës. Pas shumë diskutimesh, kur dita e 29 janarit 1990 kishte numëruar 3-4 orët e para, ata e marrin vendimin për të filluar Aksionin për Pajtimin e Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave në Kosovë.

Praktikisht, fillimin e aksionit e shënon ndërhyrja e parë e tyre në fshatin Lumbardh të Deçanit, më 2 shkurt 1990, ku është kërkuar falja e gjakut. E gjitha çka ishte nxjerrë në këtë rast, ishte një besë dymuajshe. Pjesëmarrës kanë qenë edhe profesorët Anton Çetta si dhe Zekeria Cana, të cilët i ishin bashkangjitur grupit të nismëtarëve të pajtimit të gjaqeve

pas ftesës që u ishte bërë nga ana e nismëtarëve.

Aksioni për Pajtimin e Gjaqeve shumë shpejt mori përmasat e vërteta të një lëvizjeje gjithëpopullore për pajtim si për nga numri i gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave të falura, po ashtu edhe për nga numri i veprimtarëve të cilët vullnetarisht ishin përfshirë në të, me synimin që pajtimi i filluar ndërshqiptar të përmbylej me sukses.

Në fund të periudhës njëvjeçare të veprimit, 1990-1991, Lëvizja e Pajtit të Gjaqeve në Kosovë ka shënuar, krahas qindra plagëve dhe ngatërresave, mbi një mijë gjaqe të falura. Gjeografia e pajtimit është fund e krye gjeografia e Kosovës, e Shqipërisë së këndej

Drinit, siç cilësohet me të drejtë nga poeti ynë i shkëlqyeshëm, Dritëro Agolli. Moto e veprimtarisë së saj ishte bërë motoja e Adem Demaçit: "Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit", e shprehur në romanin e ndaluar "Gjarpitje e gjakut".

Lëvizja e Pajtit të Gjaqeve në Kosovë është lëvizja më përbashkuese e popullit tonë në historinë më të re. Ajo është cilësuar si një nga format e pashembullta të rezistencës sonë.

(Shkrimi është bazuar në librin "Lëvizja e Pajtit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë", të autorit Lulëzim Etemaj, botim i shtëpisë botuese "Armagedoni", Prishtinë)

Projektligji për Turizmin vlerësohet i një rëndësie shumë të veçantë



PRISHTINË, 1 SHKURT - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të kryesuar nga Ferat Shala, kryetar. Në këtë mbledhje, në cilësinë e sponsorizuesve të projektligjeve për shqyrtim, ishte ministria e

Ministritë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, bashkë me përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie, si dhe përfaqësues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Ministria Hajdari, gjatë arsytimit

të Projektligjit nr. 08/L-074 për Turizëm, vlerësoi se ky projektligj është i një rëndësie shumë të veçantë dhe me interes kombëtar. Pas debatit, anëtarët e këtij komisioni, në mënyrë unanime e miratuan në parim këtë projektligj. Ministria Hajdari e ka arsytuar

edhe Projektligjin nr. 08/L-075 për Markat Tregtare, me ç'rast edhe ky projektligj u votua unanimit nga anëtarët e komisionit. Gjithashtu, komisioni miratoi në parim edhe Projektligjin nr. 08/L-076 për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare, për ta proceduar tutje në njërin

nga seancat plenare. Më pas, përfaqësuesit e AKP-së, para anëtarëve të komisionit, shpallorën të arriturat, të cilat, vlerësuan se kanë ndikuar në përmirësimin e imazhit të kësaj agjencie, një prej të cilave u tha se është kursimi i mjeteve buxhetore. Vetëm për periudhën tetordhjetor u tha se janë kursyer rreth 2.6 milionë euro.

Gjithashtu, zëvendëskryesuesja e Bordit të AKP-së, Syzana Dautaj-Surdullli, theksoi se faktor tjetër për përmirësimin e performancës është edhe punua intensive drejt kthimit të aseteve në pronësi të shtetit.

Në fund të kësaj mbledhje anëtarët e komisionit kërkuan nga përfaqësuesit e AKP-së, që në formë të shkruar t'ia dërgojnë Kuvendit listat e aseteve të konsoliduara, dokumentet strategjike të miratuara nga Bordi i AKP-së, si dhe raportet për çdo vendim tjetër të rëndësishëm që merret nga ana e bordit të kësaj agjencie.



PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, GABRIEL ESCOBAR DHE PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BE-SË PËR DIALOGUN, MIROSLAV LAJÇAK, KANË VAZHDUAR VIZITËN NË KOSOVË

Opozita: Marrëveshja ta sigurojë njohjen nga Serbia pa cenuar sovranitetin

Partitë opozitare i kanë dhënë mbështetje procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Pas takimit me përfaqësuesin e posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, liderët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë shprehur qëndrime të njëjta. Ata kanë vlerësuar se marrëveshja me Serbinë duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë dhe në kufijtë ekzistues të Republikës së Kosovës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 SHKURT - Liderët e partive opozitare kanë vlerësuar se procesi i dialogut Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë. Pas takimeve me përfaqësuesin e posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar dhe me përfaqësuesin e posaçëm të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, ata kanë bërë me dije se marrëveshja përfundimtare nuk duhet ta cenojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Në takimet e ndara që kanë pasur të martën me dy diplomatët në Ambasadën Amerikane në Prishtinë ata i kanë dhënë mbështetje procesit të dialogut. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se marrëveshja duhet ta respektojë integritetin territorial dhe rendin kushtetues. "PDK-ja mbështet dialogun si mekanizëm për arritjen e marrëveshjes finale

gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e cila siguron njohjen e ndërsjellë, pa cenuar sovranitetin shtetëror, integritetin territorial dhe rendin kushtetues", ka shkruar lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, në profilin e vet në "Facebook". Edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka deklaruar se ky proces duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë. Sipas njoftimit për medie të LDK-së, Abdixhiku ka mbështetur procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, i cili, sipas tij, duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë. "Kryetari Abdixhiku i njoftoi për qëndrimet e LDK-së karshi situatës politike, me theks të veçantë për procesin e dialogut, me ç'rast i bëri me dije edhe një herë që LDK-ja mbështet procesin e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, i cili duhet të përfundojë me njohje të ndërsjellë dhe normalizim të plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve duke respektuar integritetin territorial, sovranitetin

dhe rendin kushtetues të Kosovës. LDK-ja mbetet partnere kredibile e ShBA-së dhe Bashkimit Evropian në proceset e rëndësishme të vendit", është thënë në njoftimin për medie të LDK-së.

Kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se marrëveshja përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë mund të arrihet vetëm me rolin aktiv të ShBA-së. "Kam ripërsëritur përkushtimin tonë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërisht të obligueshme, e cila ka epilog njohjen reciproke në kufijtë ekzistues dhe respekton rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, gjë që mund të arrihet vetëm me rolin aktiv të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu,

i falënderova për angazhimin rreth Republikës së Kosovës Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Vizita e Escobarit dhe Lajçakut vlerësohet e rëndësishme

Ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, ka komentuar vizitën e Gabriel Escobarit dhe Miroslav Lajçakut në Kosovë. Ajo ka thënë se



Hovenier: ShBA-ja dhe Kosova, të përkushtuara për ta mbështetur Ukrainën

PRISHTINË, 1 SHKURT - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, tha se Shtetet e Bashkuara dhe Kosova janë të përkushtuara për ta mbështetur sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Në një shkrim të publikuar në uebfaqen e Ambasadës Amerikane, Hovenier tha se veprimet e Rusisë paraqesin kërcënim jo vetëm për Ukrainën, por edhe për Evropën dhe për rendin ndërkombëtar. "Së bashku me aleatët dhe partnerët tanë ne do ta ndihmojmë Ukrainën në përpjekjet e saj për t'u mbrojtur

nga agresioni i mëtejshëm rus", tha Hovenier.

Pas grumbullimit të mbi 100 000 trupave ruse përgjatë kufirit me Ukrainën, Perëndimi ka ngritur alarmin se Moska mund të jetë duke u përgatitur që ta pushtojë Ukrainën.

Në kohën e rritjes së tensioneve, Kosova ka shprehur mbështetje për Ukrainën.

Ministria e Mbrojtjes e Kosovës ka shprehur gatishmërinë që komponentë të caktuar të Forcës së Sigurisë së Kosovës t'i vendosë në dispozicion të ShBA-së në rast se i

kërkohej për ndonjë mision.

Vitin e kaluar Forca e Sigurisë e Kosovës ka qenë për herë të parë pjesë e misionit paqeruajtës ndërkombëtar në Kuvajt, së bashku me trupat amerikane.

Ambasadori Hovenier tha se Uashingtoni po vazhdon të ndërtojë një koalicion ndërkombëtar të partnerëve në Evropë dhe gjetkë, për t'iu kundërvënë kërcënimit rus. "Miqët tanë në Kosovë janë thelbësorë në këtë përpjekje. Uniteti dhe vendosmëria jonë e përbashkët transatlantike janë mjeti më efektiv

që kemi për të kundërshtuar agresionin rus. Jemi të përkushtuar ndaj diplomacisë dhe e kemi bërë të qartë se rruga diplomatike mundëson zgjidhjen e vetme të qëndrueshme për të gjithë", tha Hovenier.

Sipas ambasadorit amerikan në Prishtinë, kërcënimet e Rusisë ndaj Ukrainës është kërcënim i vlerave demokratike kudo në botë. Ai shtoi se ShBA-ja dhe Kosova qëndrojnë së bashku me Ukrainën "për të siguruar një Evropë të lirë dhe të qëndrueshme, e cila është në interesin më të mirë të popujve të

demokracive, qofshin ata amerikanë, kosovarë apo të tjerë, anembanë globit".

Rusia mohon se po planifikon ta sulmojë Ukrainën dhe ka paraqitur një sërë kërkesash për ShBA-në dhe NATO-n.

Mes të tjerash, Kremli ka kërkuar garanci nga NATO-ja se do ta ndalojë zgjerimin drejt lindjes dhe nuk do të pranojë në radhët e saj vendet ish-sovjetike, përfshirë Ukrainën. ShBA-ja dhe NATO-ja i kanë hedhur poshtë këto kërkesa, por kanë ofruar rrugë diplomatike për zgjidhjen e krizës. (rel)



vizita e përbashkët në Kosovë e emisarëve amerikanë dhe evropianë për dialogun, Escobar

dhe Lajçak, është shumë e rëndësishme për procesin e dialogut. "Vizita e përbashkët

Kosovë e emisarit amerikan dhe atij evropian për dialogun, Escobar dhe Lajçak, ka shumë rëndësi sepse

ky është momenti kur Bashkimi Evropian duhet të deklarohet zyrtarisht se angazhohet për dialog që ka në fokus njohjen reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë, ashtu njësojë siç e bëri ShBA-ja, dhe presidenti amerikan Biden gjithë e cila u konfirmua edhe nga ambasadori amerikan në Kosovë", ka shkruar Tahiri në profilin e vet në "Facebook", duke shtuar se ShBA-ja dhe BE-ja duhet të jenë në një linjë për këtë çështje. "Mendoj se Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë nga BE-ja të deklarohet se angazhohet për njohje reciproke në dialog, duke konfirmuar kështu se janë është në linjë të njëjtë me ShBA-në. Është koha dhe i takon BE-së si ndërmjetëse e dialogut të qartësojë qëndrimin e vet, duke konfirmuar qëndrimet e përbashkëta me amerikanët, që i jep kuptimin kësaj vizite të

përbashkët. Andaj, jam e bindur se ka ardhur koha që BE-ja të flasë me një gjuhë të qartë dhe të shmanget nga praktikat e mëhershme të komunikimit ambivalent, sepse kjo do të ndihmonte që ky dialog të dalë nga kjo gjendje apatie ku ndodhet tash sa vite", ka shkruar Tahiri.

Një ditë më parë i dërguari i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, kanë takuar presidenten e vendit, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Dy diplomatët, në një konferencë për medie, kanë inkurajuar udhëheqësit e Kosovës që ta vazhdojnë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, duke thënë se ky proces do ta afrojë Kosovën edhe më pranë BE-së.




Të gjitha rrugët në komunën e Rahovecit janë të kalueshme

RAHOVEC, 1 SHKURT - Bora që ka rënë në gjithë territorin e komunës së Rahovecit nuk ka paraqitur vështirësi në qarkullim, pasi që kompanitë e kontraktuara

për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror kanë dalë me kohë në terren për të bërë pastrimin e borës. Përparim Krasniqi, drejtor

i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në komunën e Rahovecit, ka thënë se të martën në mëngjes, pas reshjeve të borës, kompanitë e kontraktuara

nga komuna janë duke u kujdesur në pastrimin e rrugëve dhe se të gjitha rrugët në tërë territorin administrativ të komunës janë të kalueshme.



Rihapet Qendra e Mjekësisë Familjare në Likoc

SKENDERAJ, 1 SHKURT - Është rihapur Qendra e Mjekësisë Familjare në Likoc, pasi ishte mbyllur që nga tetori i vitit të kaluar për shkak të procesit të rinovimit.

Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe drejtoresha për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale, Rrezarta Hasani-Ibrahimi, kanë vizituar këtë qendër mjekësore, ku janë pritur nga personeli mjekësor. Me këtë rast, kryetari Nura i ka siguruar mjekët dhe infermierët e QMF-së në Likoc, përkrahje për furnizim të materialit dhe nevojave të tjera që kërkohen, me qëllim që qytetarët, përkatësisht pacientët, të kenë shërbimin sa më cilësor.

Në një reagim në "Facebook", i pari i Skenderajt ka shkruar: "Punët e mira për t'i përmirësuar shërbimet shëndetësore në komunën e Skenderajt vazhdojnë. Ashtu siç kemi premtuar, nga sot është rihapur Qendra e Mjekësisë Familjare në Likoc, pas funksionalizimit para tri dite të repartit të radiologjisë në QKMF. Pas rrënimit të një ndërtimi pa leje në oborrin e kësaj qendre në Likoc, nga sot këtu rikthehen shërbimet mjekësore për pacientët e kësaj bashkësie lokale, pa qenë nevoja të bëjnë kilometra udhëtim në kërkim të mjekimit. Mjekëve u uroj sa më pak punë!", ka shkruar Nura.



Drejtorja për Shërbime Publike vazhdon mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Mitrovicë

MITROVICË, 1 SHKURT - Në Sallën e Kuvendit Komunal, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Granit Tmava, së bashku me drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahtir Maxhuni, kanë pritur në takim familjet e dëshmorëve në Mitrovicë. Qëllimi i këtij takimi ka qenë i karakterit informues lidhur me renovimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve në Shipol të Mitrovicës. Në këtë takim u pajtuan që t'i

kushtohet kujdes i veçantë rregullimit të emrave dhe fotove në pllakat e varrezave, si dhe të vazhdohet mirëmbajtja e të gjitha varrezave të dëshmorëve në Shipol.

Gjithashtu, drejtori i DShPI-së, Tmava, ka theksuar se, përveç mirëmbajtjes së këtyre varrezave, drejtorja të cilën e udhëheq ai do t'i mirëmbajë të gjithë lapidarët dhe pllakat përkujtimore të vendosura në tërë territorin e Mitrovicës.

Hyseni pret në takim kryetaren e Preshevës, temë diskutimi shqiptarët në Luginë

GJILAN, 1 SHKURT - Kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim kryetaren e Preshevës, Ardita Sinani. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim kryetaren e komunës së Preshevës, Ardita Sinani. Pasi e ka falënderuar për vizitën, kryetari Hyseni ka thënë se me kryetaren Sinani kanë diskutuar rreth situatës aktuale dhe për sfidat me të cilat përballen shqiptarët e

Luginës. "Prita në takim kryetaren e komunës së Preshevës, Ardita Sinani. Diskutuam rreth situatës aktuale dhe sfidat me të cilat përballen shqiptarët e Luginës. Në përfundim të takimit ishte konstatim i përbashkët, që të vazhdohet bashkëpunimi i ndërsjellë për identifikimin e sfidave, mundësive dhe gjetjen e zgjidhjeve konkrete", ka thënë kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.



Mbi 36 mijë seanca të hemodializës u mbajtën në Repartin e Dializës

PRISHTINË, 1 SHKURT - Mbi 36 mijë seanca të hemodializës u mbajtën në Repartin e Dializës në Klinikën e

Nefrologjisë përgjatë vitit 2021, thotë raporti vjetor i punës. Pos tyre, kjo klinikë ka ofruar, njashtu, 301 shërbime

të transfuzionit dhe mijëra shërbime dijonistike, mes tyre 1 028 Eho të Abdomenit dhe 1 0190 EKG. Gjatë

periudhës janar-dhjetor 2021 në Klinikën e Nefrologjisë u realizuan edhe 2 418 mijë vizita ambulatore.



Kosova regjistron gjashtë viktime nga Covidi dhe mbi 2 mijë raste të reja

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 SHKURT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të martën, më 1 shkurt, se janë regjistruar edhe gjashtë viktime dhe 2 033 raste të reja me Covid-19, pas testimit të 10 087 mostrave. Shkalla e pozitivitetit nga mostrat e marra është 20.15 për qind. Autoritetet shëndetësore kanë njoftuar se 3 329 edhe persona janë shëruar, ndërsa 32 906 janë raste aktive. Kosova ka nisur fushatën e vaksinimit kundër koronavirusit në mars të vitit të kaluar. Prej atëherë janë dhënë mbi 1.7 milion doza të vaksinës.

Deri më tani me dy doza të vaksinës janë imunizuar 805 802 persona. Qytetarët në Kosovë mund të marrin vakcina të kompanive: "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca". Doza përforcuese e vaksinës mund të merret pas tre muajve të marrjes së dozës së dytë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Omicroni po vazhdon të përhapet me intensitet të lartë dhe është varianti dominues në qarkullim që po rëndon gjithnjë e më tepër situatën epidemiologjike dhe mund t'i ngarkojë institucionet shëndetësore në ditët në vijim me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve. "Virusi është kudo andaj mos neglizhoni rekomandimet themelore: maskën, distancën, higjienën. Shmangni udhëtimet, qëndroni në shtëpi dhe ajrosni ambientet e

mbyllura. IKShPK është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik, andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes, rekomandohen të testohen", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas këtij instituti, situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë në ditët në vazhdim. "IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim. Ndërsa u rekomandojmë institucioneve përgjegjëse t'i mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se është i domosdoshëm kujdesi i shtuar i të gjithëve që në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, të përdoret maska, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e hapësirave, duke pamundësuar dhe shmangur përhapjen eventuale të mëtejme të infeksionit të Covid-19. "Omicroni është tejet ngjitës, andaj mbani maskën në çdo vend, mbani distancën mbi dy metra edhe në mjedise të hapura edhe po qe se të gjithë bartin maska. Duke qenë se vaksinimi është mënyra më e mirë



dhe më e sigurt për ta parandaluar Covid-19, veçanërisht formave të rënda të sëmundjes dhe vdekjeve, ne vazhdojmë të apelojmë fuqishëm për vaksinim sa më gjithëpërfshirës, sa më të gjerë dhe sa më të shpejtë të popullatës nga mosha 12-vjeçare. Vaksinat mund të merren çdo ditë në të gjitha institucionet e kujdesit parësor në komunën tuaj. Gjithashtu, apelojmë për vaksinimin me dozën përforcuese dhe dozën e tretë që mund ta marrin të gjithë qytetarët e moshës mbi 18-vjeçare", ka njoftuar IKShPK-ja.

Avokati i Popullit kërkon të rishqyrtohen masat kundër Covid-19

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, në një opinion publik lidhur me masat në fuqi kundër

koronavirusit, ka thënë se qeveria duhet ta rishqyrtojë masën e kufizimit të qarkullimit nga ora 22:00 deri në orën 5:00.

Avokati i Popullit ka thënë se në vend të kufizimit të qarkullimit "do të ishte më e dobishme që të fuqizoheshin mekanizmat e kontrollit sanitar dhe inspektoratet, në mënyrë që të ushtrohen kontrole më të shpeshta për të vlerësuar nëse janë duke u zbatuar masat e përgjithshme, tanimë të njohura". "Praktikat e vendeve të rajonit tregojnë se asnjëra prej tyre nuk kërkon nga qytetarët që hyjnë në territoret e tyre t'i kenë tri doza të vaksinës", thuhet në opinion.

Po ashtu, aty thuhet se pjesa më e madhe e shteteve, që nga fillimi i pandemisë, në hyrje-dalje të kufijve të tyre i kanë pranuar testet antigjenë, të cilat janë më të shpejta dhe më të përballeshme

për xhepin e qytetarëve.

Në pikat kufitare të Kosovës, qytetarëve u kërkohet testi RT-PCR, i cili është dyfish më i shtrenjtë dhe merr më shumë kohë për t'u përpunuar në laborator.

Në Kosovë nga data 22 janar janë në fuqi masat e reja për luftim të pandemisë së koronavirusit.

Qytetarët që hyjnë në Kosovë duhet të jenë të vaksinuar plotësisht dhe të kenë edhe dozën përforcuese apo nëse nuk e kanë dozën e tretë, të kenë test negativ të llojit PCR, të vlefshëm për 48 orë.

Me masat e reja është kufizuar qarkullimi nga ora 22:00 deri në orën 05:00. Bizneset e gastronomisë zhvillojnë aktivitetin e tyre nga ora 05:00 deri më 21:00. Muzika në këto biznese lejohet deri në orën 20:30.

Kosova dhe Zvicra fillojnë bashkëpunimin për përgatitjen profesionale të mjekëve të rinj

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 SHKURT - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Zvicrës, Thomas Kolly dhe zëvendësrektorin për bashkëpunim në Ambasadën e Zvicrës, Laurent Tourche. Ministri Latifi ka falënderuar shtetin e Zvicrës dhe personalisht ambasadorin Kolly për ndihmën e dhënë tash e disa dekada për Kosovën dhe zhvillimin e saj, ndihmë kjo, po ashtu, e drejtuar drejt përmirësimit të sistemit shëndetësor në vendin tonë, posaçërisht të kujdesit parësor. Gjithashtu, ministri Latifi ka falënderuar Zvicrën edhe për ndihmën e ofruar në ballafaqim me pandeminë Covid-19, si dhe për gatishmërinë që të ndihmojë në të ardhmen rreth furnizimit me vakcina.

Me këtë rast, ministri Latifi ka

shtuar se gjatë disa muajve të fundit vendi ynë ia ka dalë me mjaft sukses ta përballojë pandeminë, megjithatë ka theksuar se duhet të vazhdojmë përqendrimin dhe ta mbajmë gjendjen nën kontroll, pasi që Covid-19 ende nuk ka përfunduar.

Një nga pikat kryesore të takimit ishte edhe mundësia e fillimit të bashkëpunimit me qëllim përgatitjen profesionale të mjekëve të rinj nga Kosova përmes kontributit të kuadrove dhe institucioneve përkatëse akademike dhe shëndetësore të Zvicrës. Kështu, të dyja palët u pajtuan që për këtë temë të përgatiten edhe pikat konkrete që ky bashkëpunim të fillojë në të ardhmen e afërt.

Në konkluzion, gjithashtu, u diskutua edhe për krijimin e Qendrës Klinike Ekselente, si investim tejet i rëndësishëm për sistemin shëndetësor të Kosovës.



Qeveria i propozon ZRRE-së që blloktarifa të jetë 1 000 kWh e jo 600 kWh

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 SHKURT - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka paraqitur në emër të Qeverisë së Kosovës komentet që kanë dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) lidhur me tarifën e energjisë elektrike. “Dje si Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve kemi dorëzuar komentet dhe propozimet tona mbi raportet konsultative të ZRRE-së për të hyrat maksimale të lejuara dhe për strukturën tarifore. Propozimet tona për raportin e të hyrave maksimale janë që të zvogëlohet hendeku nga 132 milionë euro në 110 milionë euro, duke përfshirë në llogaritje edhe potencialin për zvogëlim të konsumit, gjë do të rezultonte me rreth 15 milionë euro neto kursim në import; korrigjuar llogaritjen e humbjeve të lejuara për KEDS-in për 66 GWh, apo rreth 7 milionë euro dhe, po ashtu, kemi propozuar që ZRRE-ja të llogarisë si kontigjencë të të hyrat maksimale të lejuara shumë prej 40.8 milionë eurosh, të cilën gjykata ka kërkuar t’u kthehet konsumatorëve nga KEDS-i, meqenëse vendimi është apeluar dhe ende pret verdiktin përfundimtar”, ka thënë Murati.

Qeveria i ka propozuar ZRRE-së që blloktarifa të jetë 1 000 kWh e jo 600 kWh. “Propozimet tona për raportin e strukturës tarifore janë: Të rritet pragu i bllokut tarifor në 1 000 kWh ashtu që ky bllok të jetë i ndarë në 500 kWh që mund të shfrytëzohen me tarifë të ditës dhe 500 kWh të tjera me tarifë të natës. Kësisoj, çmimet me këtë bllok mbeten të pandryshuara për të gjitha familjet që nuk tejkalojnë bllokun. Barra të ndahet proporcionalisht edhe nga bizneset ashtu siç u kërkua nga shumë grupe parlamentare në debatin që u zhvillua në Kuvend për këtë temë. Pjesa e mbetur do të subvencionohet nga qeveria”, ka thënë Murati.

Osmani e konsideron ndëshkues dhe diskriminues propozimin për shtrenjtim të rrymës, jep opsione të tjera

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka listuar një sërë rekomandimesh për Zyrën e Rregullatorit të Energji


Kosovo Electricity Supply Company				
Fatura - Bill - Račun 18116382				
Adresa: Bulevardi Be Çikullin, 3, 11000 Prishtinë TYPITOL: JAVIKENJE NR-IB: 1017/2017				
DPR - 3521				
Emri i konsumatorit: H. Rr. p.n.-LPRISHTINE				
Gjendja e tanishme / Current reading / Sačetašnje stanje				
A1/R1	21714.00			
A2/R2	27418.00			
Gjendja paraprake / Previous reading / Prethodno stanje				
A1/R1	21278.00			
A2/R2	26838.00			
Diferenca / Difference / Razlika				
A1/R1	444.00			
A2/R2	589.00			
Konsumi Muaj / Monthly Consumption / Mesecna Potrošnja				
A1/R1	444.00			
A2/R2	589.00			
Kursimi Muaj / Monthly Consumption / Mesecna Potrošnja				
H1/R1	117	0.8555	4.63	
H2/R2	113	0.9279	3.15	
H3/R3	173	0.9778	13.32	
H4/R4	227	0.3586	8.76	
H5/R5	184	0.1117	20.55	
H6/R6	218	0.3559	15.39	
P - neto				
Tarifa Fikso / Standard Charge / Fiksna Tarifa				
2.50				
Neto / Nett / Netto				
66.50				
0.00				
0.00				
TVSH / VAT / PDV				
5.32				
Total / Faturës / Bill Amount / Ukupan Račun				
71.82				
71.82				

(ZRRE) në komentet që ia ka dërguar këtij organi, i cili më 17 janar ka publikuar një raport konsultativ me propozimin për shtrenjtim të energjisë elektrike. Osmani ka konsideruar se struktura tarifore e propozuar nga ZRRE-ja është ndëshkuese dhe diskriminuese ndaj vetëm një grupi të shoqërisë, përderisa përgjegjësia për rritjen e konsumit është e të gjithëve. Sipas presidentes, me propozimin e ZRRE-së, 39 për qind e konsumatorëve shtëpiakë do ta bartin barrën e shtrenjtimit të gjithëmbarshtëm të energjisë elektrike në vend. Në raportin ku ZRRE-ja ka dizajnuar tarifën e reja të energjisë elektrike është thënë se është marrë për bazë edhe respektimin e objektivitetit të reflektimit të kostos për shërbimin që e marrin konsumatorët. Sipas presidentes Osmani, ky kriter që kërkon shmangien e diskriminimit ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve nuk është përmbushur në raportin e ZRRE-së. Objektivi i përshkuar për

ZRRE-në është që tarifën e paguar nga konsumatorët duhet, për aq sa është praktikisht e mundur, t’i pasqyrojnë kostot që ata ia ngarkojnë sistemit. Në këtë çështje presidentja ka vërejtje. “Struktura e propozuar tarifore nga ZRRE, e cila e vë prapin e konsumit në 600kWh/muaj (përtej këtij niveli të konsumit aplikohet rritja e çmimit të energjisë elektrike), rrezikon të jetë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me këtë objektiv. Me strukturën tarifore të propozuar, 39 për qind e konsumatorëve shtëpiakë do ta bartin barrën e shtrenjtimit të gjithëmbarshtëm të energjisë elektrike në vend. Edhe përkundër faktit që propozohet që përqindje të caktuara të rritjes së çmimit të energjisë për secilën kategoritë të mbulohe nga subvencionimi i qeverisë (duke përfshirë edhe grupin e konsumatorëve mbi 600kWh), struktura aktuale tarifore shihet si ndëshkuese dhe diskriminuese ndaj vetëm një grupi të shoqërisë, përderisa përgjegjësia për rritjen e konsumit është e përbashkët”,

është thënë në komentet e dërguara nga presidentja Osmani. Zyra e Presidencës ka konsideruar se rikthimi në tri bllok-tarifë, siç ishte para vitit 2017, do të ishte një trajtim më korrekt ndaj konsumatorëve dhe se kjo do ta shpërndante në mënyrë më të barabartë rritjen e çmimit të rrymës. “Rrjedhimisht, ZPRK-ja propozon që në strukturën tarifore aktualisht të propozuar nga ZRRE-ja, mos të ketë vetëm një kufi të ndarjes në mes të konsumatorëve, por të shtohen dhe dy blloqe të reja. Një strukturë e tillë tarifore do të ndihmonte që të bëhej dallimi në mes të konsumatorëve që me konsumin e energjisë elektrike mbulojnë nevojat më bazike, konsumatorëve të cilët paraqesin një ekonomi familjare me shpenzime mesatare, dhe konsumatorëve të cilët me raste të caktuara e shfrytëzojnë energjinë elektrike për nevojat të luksit”, është thënë në propozimin e presidentes. Osmani ka kërkuar që edhe bizneset të përfshihen në

skemën e re tarifore, të cilat, sipas propozimit paraprak nga ZRRE-ja, nuk prekeshin nga shtrenjtimi i rrymës. Kjo, sipas presidentes, do ta lehtësonte barrën për konsumatorët shtëpiakë. “Me propozim të strukturës tarifore me tri blloqe, përkundër rritjes së çmimit të energjisë, rritja do të ishte dukshëm më e përbalueshme për të gjithë dhe në mënyrë të tillë, edhe shuma e subvencionit të ofruar nga qeveria do të mund të përdorej për mbulimin e barrës së më shumë kategorive të konsumatorëve në mënyrë më të njëtrajtshme. Në të kundërtën, në rast të hezitimit të rikthimit në 3 blloqe tarifore, duhet të shqyrtohet mundësia e rritjes së pragut prej 600kWh/muaj”, është thënë në këtë propozim. Gjithashtu, ZRRE-së i kërkohet edhe që para aprovimit të skemës së re tarifore, të kërkojë përgatitjen e një plani energjetik të shkëmbimit të energjisë elektrike me Shqipërinë, duke u bazuar në frymën e bashkimit të tregjeve elektrike.



Ja se si Kina e spiunon Perëndimin



Nga Ian WILLIAMS
"The Spectator"

Dhjetorin e vitit të kaluar, studentëve të Universitetit të Oksfordit iu ofruan nga 15 mijë paund, nëse do të zgjidhnin sfidat në lidhje me mbikëqyrjen dhe gjurmimin e pajisjeve dhe përdoruesve të tyre. "Huawei kërkon të përzgjedhë studentët më të mirë në Sfidën e tyre Universitare 2021" - thuhej në ofertë.

Kompania theksonte se kjo teknologji do të përdorej për "shërbimet e biznesit" dhe "shërbimet e sigurisë". Ftesa Huawei synonte studentët e shkencave të dhënave, dhe u transmetua nga shërbimi i karrierës në Universitetin e Oksfordit vetëm disa javë përpara Krishtlindjeve.

Kur një studente pyeti nëse ishte e përshtatshme që shërbimi i karrierës ta transmetonte këtë ftesë, kur teknologjia e Huawei është përgjegjëse për shtypjen e ujqurëve në Xinjiang, ajo mori një përgjigje të fshehtë. "Ne ofrojmë një shërbim të paanshëm" - thuhej në të, dhe varet nga studentët nëse duan të angazhohen apo jo.

Është e vështirë të thuhet se cila ishte pjesa më tronditëse e incidentit. Guximi i një kompanie që njihet për lidhjet e ngushta me Partinë Komuniste Kineze, dhe së cilës i është ndaluar të ndërtojë rrjetet e telekomunikacionit 5G në Britani për arsye sigurie? Apo indiferenca e dukshme e Universitetit të Oksfordit?

Apo ky është vetëm një shembull i mënyrës së pacipë, me të cilin kompanitë e lidhura me PKK-në

janë në gjendje të gjurmojnë për informacione dhe teknologji në Britani. Termi "qingbao" që në gjuhën kineze do të thotë "inteligjencë" po ashtu edhe "informacion", përmbledh mjeshtërisht natyrën unike dhe sistemin e gjerë të spiunazhit të Kinës, i cili kombinon teknikat formale dhe joformale, të hapura dhe të fshehta, për të mbledhur informacione të reja.

Ekziston shpesh një vijë shumë e hollë midis vjedhjes dhe transferimit vullnetar të njohurive, dhe Kina e ka çuar në limite këtë të fundit. Gjatë viteve të fundit, PKK ka ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës për zbulimin dhe përvetësimin e teknologjive të huaja, duke përdorur shumë mjete.

Spiunët kibernetikë të Kinës, janë vetëm njëra nga fytyrat e këtij sistemi. Ata kanë hakuar në një shkallë industriale kompjuterat e kompanive perëndimore. Objektivat përputhen me teknologjitë e avancuara të identifikuar nga PKK si ato në të cilat Pekini dëshiron që të jetë lider në botë.

Në një operacion, mbi të cilin u informova gjatë kërkimit të një libri mbi mbikëqyrjen dixhitale kineze, hakerat depërtuan në një kompani amerikane të naftës duke infektuar menynë online të një restoranti kinez në zonë, ku inxhinierët e sistemeve porosisnin ushqimet e tyre.

Kur inxhinierët klikuan mbi gjellën "Pula e gjeneralit Tso", ata morën shumë më tepër sesa mishin e ëmbël dhe krokant. Shkalla e hakërimit është befasuese. Kreu i Zyrës Kombëtare të Kundërzbulimit në SHBA, i përshkroi hakerat kinezë

si "më aktivët dhe më këmbëngulës në spiunazhin ekonomik në botë".

Ndërkaq gjenerali Keith Alexander, në atë kohë kreu i Komandës Kibernetike të SHBA-së dhe Agjencisë Kombëtare të Sigurisë, e cilësoi si "transferimin më të madh të pasurisë në histori" humbjen e pronësisë intelektuale të Amerikës dhe informacioneve të tjera industriale nëpërmjet spiunazhit kibernetik.

Pavarësisht shkallës së sulmeve, hakerat shpesh lënë pas gjurmët dixhitale të gishtërinjve, të cilat mund të gjurmohen në Kinë. Vitin e kaluar, Britania iu bashkua SHBA-së, BE-së, Australisë dhe aleatëve të tjerë në akuzat se Pekini kishte punësuar grupe kriminale për të depërtuar në sistemet e e-mailit të Microsoft-it, një veprim ky që kishte prekur dhjetëra mijëra kompani dhe organizata të sektorit publik në mbarë botën.

Ai denoncim i koordinuar ishte i paprecedentë. Në raportin e saj vjetor të vitit 2021, Qendra Kombëtare e Sigurisë Kibernetike në Britani, shprehej se "incidentet" kibernetike po ndodhnin në nivel rekord, dhe se kërkimi mbi vaksinën Covid-19, ishte bërë objektivi kryesor për hakerat.

"Kina mbeti një aktor shumë i sofistikuar në hapësirën kibernetike, me ambicie në rritje për ta projektuar ndikimin e saj përtej kufijve, dhe me një interes mbi sekretet tregtare të Mbretërisë së Bashkuar"- paralajmëroi ai. Edhe kreu i shërbimit sekret britanik, MI5, Richard Moore tha se Kina është tani prioriteti i vetëm më i madh i

organizatës së tij.

Agjencia kryesore e spiunazhit në Kinë, është Ministria e Sigurisë së Shtetit, Guoanbu, e cila është përgjegjëse për zbulimin e huaj dhe kundërzbulimit, dhe që renditet ndër agjencitë më të mëdha të inteligjencës në botë. Ndërkaq, Ushtria Çlirimtare Popullore ka organizata paralele. Puna e shërbimeve sekrete është e koordinuar ngushtë me Departamentin e Punës së Frontit të Bashkuar (UFWD), që përqendrohet tek operacionet e ndikimit, dhe që është zgjeruar shumë nën udhëheqjen e Xi Jinping. Christine Lee, qëu përjashtua javën e kaluar nga MI5 si agjente kineze, dyshohet se punonte pikërisht për UFWD.

Aty ku Guoanbu ka rekrutuar agentë konvencionalë, UFWD është përpjekur të përqendrohet tek njerëzit me origjinë etnike kineze, nga të cilët ajo mendon se mund të kërkojë besnikëri. Organizata është akuzuar për përdorimin e LinkedIn për të rekrutuar agentë të mundshëm, duke synuar që t'i joshë ata të shkojnë në Kinë për takime rreth punëve "të mirë-paguara" përpara se t'i rekrutojë.

Por agentët konvencionalë, priren të kenë një vend të dytë në strukturën e shërbimeve sekrete kineze, për arsyen e thjeshtë se metodat e saj joformale kanë qenë shumë më të frytshme. Ky është veçanërisht rasti në arsimin e lartë.

Nuk ka kuptim të vjedhës apo të blesh, kur universitetet perëndimore syleshë, mund të binden të japin vetë informacione shumë të ndjeshme pa asnjë lloj pagese. Kështu, pjesa më e madhe e veprimtarisë së shërbimeve


sekrete të Kinës, kryhet nga një rrjet jozyrtar akademikësh, studentësh ose njerëzish të biznesit, të cilët e ndihmojnë sa dhe kur munden PKK-në.

Kjo gjë paraqet një sfidë të madhe për agjencitë britanike të inteligjencës, pasi del jashtë ligjeve aktuale të spiunazhit. Kina ka krijuar një rrjet të organizatave të miqësisë dhe kulturore "për përdorim të dyfishtë".

Brenda arsimit të lartë, institutet e Konfucit bëjnë gjoja sikur u mësojnë studentëve të huaj gjuhën kineze, ndërsa Shoqata e Studentëve dhe Dijetarëve të Kinës, merret zyrtarisht me mirëqenien e studentëve kinezë, grupimi më i madh i vetëm i studentëve të huaj në universitetet britanike.

Por që të dyja janë të akuzuara për propagandë, spiunim ndaj studentëve si dhe frikësim të kritikëve. Ndërkombëtarisht, ato janë të hetuara dhe nën sanksione, por vazhdojnë që t'u jepet liri veprimi në Britani. Një metodë tjetër e preferuar e mbledhjes së inteligjencës ka qenë nëpërmjet qendrave të përbashkëta kërkimore ose financimit të projekteve kërkimore. Bashkëpunimet kërkimore Britani-Kinë u rritën me 115.6 për qind midis viteve 2013-2019.

Fatmirësisht, ka disa shenja inkurajuese se bota po ndërgjegjësohet për rreziqet. Atletëve britanikë që do marrin pjesë në Lojërat Olimpikë Dimërore, u janë ofruar telefona të përkohshëm që janë të vështirë të përgjohen. Edhe drejtuesit e biznesit perëndimor që vizitojnë Kinën pajisen me laptopë dhe telefona specialë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Sot dy ndeshje në Ligën Unike

PRISHTINË, 1 SHKURT - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e dhjetë në Ligën Unike.

Sfida e parë do të jetë ndërmjet Rahovecit dhe Prizreni 16, një takim shumë interesant, pasi është i vlefshëm edhe për "Art Motion Superligën" e Kosovës në basketboll. Vreshtarët kanë tri fitore e gjashtë humbje në Ligën Unike, ndërsa prizrenasit gjashtë fitore e tri humbje. Takimi i dytë zhvillohet ndërmjet Tirana Neptun dhe Vllaznisë. Tiranasi kanë katër fitore e pesë humbje, ndërsa shkodranët dy fitore e pesë humbje, ku së fundi shënuan fitore ndaj Kamza Basket. Lideri dhe kampioni Golden Eagle Ylli do të sfidohet nga Teuta e Durrësit. Therandasit janë në formë të jashtëzakonshme si në Ligën Unike, po ashtu edhe në elitën e basketbollit të Kosovës. Ylli ka tetë fitore e një humbje, ndërsa durrsakët pesë fitore e katër humbje. Humbja e vetme e Yllit ka ardhur nga Teuta me shifrat 78:72. Ndeshja e fundit do të zhvillohet ndërmjet Kamza Basket dhe Pejës. Kamza ka dy fitore e shtatë humbje, ndërsa pejanët gjashtë fitore e tri humbje.

LIGA UNIKE - JAVA 10

Të mërkurën takohen:

17:00 Rahoveci - Prizreni 16
17:00 Tirana Neptun - Vllaznia

Të enjten takohen:

17:00 Golden Eagle Ylli - Teuta
17:00 Kamza - Peja



Statistikat e xhiros së 18-të në Superligën e basketbollit

Në fundjavë u zhvillua xhiroja e 18 e "Art Motion Superligës", ku të gjitha skuadrat vendase shënuan fitore. Skuadra me efektshmërinë më të lartë në Superligë është Trepça, me 1925 pas 18 ndeshjeve. Skuadra me mesataren më të lartë të pikëve është Prizreni 16 me 96.31 për ndeshje, e pasuar nga Peja me 90.64 dhe Trepça me 88.67. Kërcime më së shumti ka Rahoveci. Vreshtarët kanë

mesatare prej 43.31 për ndeshje, Prizreni 16 me 42.85 dhe Bashkimi me 42.28. Më së shumti asistime për ndeshje ka Prizreni 16 me 22.92 për ndeshje, duke u pasuar nga Sigal Prishtina me 22.83 për ndeshje dhe Rahoveci me 22.31. Sa iu përket topave të vjedhur prin Golden Eagle Ylli me 9.14 për ndeshje, Sigal Prishtina me nëntë dhe Drita me 8.89. Mitrovicasit prijnë edhe me bllokada, me mesatare prej 3.39 për ndeshje, Rahoveci me 2.85 dhe Prizreni 16 me 2.69.

SHKURT

Tahiri fillon stërvitjet në Kinë

Albin Tahiri ka zhvilluar stërvitje të martën në Qendrën Skitare në Yanqing të Kinës për t'u ambientuar me kushtet klimatike dhe temperaturat e ulëta. Shtegu për përgatitje në garën e lëshimit hapet të enjten. Ndërkohë, Kiana Kryeziu nis përgatitjet sot (e mërkurë). Ajo do të përgatitet për sllallom të madh.

Kumbulla ka edhe një rast te Roma

AS Roma në afatin kalimtar të janarit bëri vetëm dy transferime, por në verë parashikohet një revolucion në shkallë të gjerë. Sipas "Corriere dello Sport", vetëm Pellegrini, Spinazzola, Rui Patricio, Sergio Oliveria, Zaniolo dhe Abraham e kanë vendin e sigurt, të gjithë lojtarët e tjerë, përfshirë këtu edhe Marash Kumbullën, do të jenë nën provim. E ardhmja e Kumbullës dhe pjesës tjetër do të varet nga performanca e tyre deri në fund të këtij sezoni.

Bonner SC transferon Bunjakun

Albert Bunjaku është bërë me skuadër të re, duke sinjalizuar se nuk e ka ndër mend të pensionohet nga futbolli. Ish-reprezentuesi i Kosovës ka nënshkruar me skuadrën që luan në Regionalliga West, Bonner SC, deri në fund të sezonit me mundësi vazhdimi. Drejtori sportiv Danierl Zillken është shprehur shumë i kënaqur me transferimin e Bunjakut, duke thënë se sulmuesi sjell shumë përvojë në skuadrën e tyre. "E njoh shumë mirë Albertin nga koha ime te Viktoria. Jam shumë i lumtur që mund ta forcojmë sulmin tonë me këtë transferim. Me përvojën e tij, Alberti është aset dhe do të na ndihmojë në garën për ekzistencë", ka thënë ai. Bunjaku ka luajtur për skuadra si Schaffhauseni, Paderborni, Erfurti, Nürnbergu, Kaiserslauterni, St. Galleni, Erzgebirge Aue e Viktoria Koelni.

Beqiraj arrin marrëveshje me Deçiçin

Reprezentuesi i Malit të Zi, Fatos Beqiraj, ka arritur marrëveshje me klubin shqiptar Deçiçi në ligën elitare të Malit të Zi. Sulmuesi nga Peja, Beqiraj, iu bashkua Deçiçit nga Astana si lojtar i lirë në ditën e fundit të afatit kalimtar të janarit. Kështu në moshën 34-vjeçare dhe 12 vjet më vonë, Beqiraj u kthye në futbollin malazez te klubi shqiptar i Tuzit, një qytet me vetëm katër mijë banorë. Deçiçi është i dyti në tabelë në kampionatin malazez, por ngel plot tetë pikë mbrapa liderit Sutjeska. Beqiraj, i cili u lind dhe u rrit në Pejë dhe luajti për Shqiponjën dhe Besën, është lojtari me më së shumti paraqitje për Kombëtaren e Malit të Zi.

Llapi paraqet sulmuesin Latif

KF Llapi ka bërë paraqitjen zyrtare të sulmuesit Abedel Latif Amadu në ambientet e hotelit "Aska Lara Resort" në Antali, aty ku skuadra po vazhdon të përgatitet për stinorin e ri. Latifi, i cili kontratën gjashtëmujore me opsion rinovimi edhe për edicionin e ardhshëm, e ka firmosur muaj më parë dhe pas kompletimit të dokumentacionit u është

bashkuar shokëve në përgatitje. 28-vjeçari i lindur më 20 gusht 1993 në Acora të Ghanës dhe i gjatë 190 cm ka bërë karrierë në këto skuadra: Berekum Chelsea FC (Ghanë), Asante Kotoko SC (Ghanë), Dynamo Brest (Bjellorusi), KF Teuta (Shqipëri), SC Kfar Qasem (Izrael), Al-Khaalej (Arabi Saudite) dhe Al-Ansar (Arabi Saudite). Latifi shkëlqimin

më të madh në karrierë e ka pasur te skuadra shqiptare, KF Teuta, me të cilin ishte paraqitur në 66 ndeshje zyrtare (63 kampionat/3 kupë) dhe kishte realizuar 19 gola. Sulmuesi shtatëmbëdhjetë vjeçar vjen nën urdhrat e trajnerit Tahir Batatina dhe do të jetë forcë shtesë për bardhekaltrit në pjesën pranverore të kampionatit dhe ndeshjeve të Kupës.

Muriqi, pas transferimit te Mallorca: Jam shumë i emocionuar për sfidën e re

MALLORCA, 1 SHKURT - Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, është deklaruar për herë të parë si lojtar i RCD Mallorca. Sulmuesi "dardan" është larguar nga Lazios në formë huazimi në drejtim të skuadrës spanjolle. Përmes një

pozite në "Instagram", Muriqi ka përshëndetur klubin e ri dhe tifozët e tyre. "Përshëndetje RCD Mallorca! Jam shumë i emocionuar për sfidën e re. Shihemi së shpejti në Mallorca Estadi", thuhet në postimin e tij.

Muriqi disa sezona më parë ka luajtur në Turqi, ku ka shënuar 76 gola në 210 ndeshje. Në vitin e tij të fundit në futbollin turk, pak para se të transferohej në Itali, ai shënoi 17 gola në 36 ndeshje për Fenerbahçen.



Dele Alli: Pres me padurim të luaj në ndeshjen e parë me fanellën e Evertonit

LIVERPOOLI, 1 SHKURT - Në minutat e fundit para mbylljes së merkatos së dimrit në Angli, Evertoni ka realizuar një nga goditjet më të rëndësishme të gjithë sesionit. Klubi, në fakt, ka marrë Dele Alli, i cili është larguar nga Tottenhami pas

gjashtë vitesh e gjysmë. Lojtari ka nënshkruar një kontratë deri më 30 qershor të 2024-s me Toffees. "Jam i lumtur që kam nënshkruar me Evertonin, një klub i madh me një histori të madhe dhe një tifozeri speciale", ka thënë Dele Alli.

"Pres me padurim të luaj ndeshjen e parë me këtë fanellë. Dua ta ndihmoj skuadrën dhe të jem i lumtur. Është një mundësi e madhe për mua të punoj me Lampardin. E adhuroja kur ishte lojtar dhe është shumë entuziazmuere të

punoj me të", ka shtuar Dele Alli. Siç është shpjeguar në faqen e Evertonit, Dele Alli mund të debutojë pas një jave, kur Toffees do të luajë në fushën e Newcastle.



U dorëzuan stemat e reja të FIFA-s për 13 gjyqtarë



PRISHTINË, 1 SHKURT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, të martën kanë dorëzuar stemat e reja të FIFA-s për 13 gjyqtarë, në mesin e tyre edhe dy femra, Lumnije Muhadri dhe Florentina Kallaba. Paraqitjet e mira të gjyqtarëve tanë në arenën ndërkombëtare kanë bërë që FIFA t'i konfirmojë stemat për: 3 gjyqtarë kryesorë, 7 asistentë si dhe 3 gjyqtarë të futbollit.

Vlen të theksohet se që nga ky vit, në bazë të kategorizimeve që bën

UEFA, gjyqtarët kryesorë dhe ata të futbollit janë avancuar në kategorinë e dytë. Kryetari Ademi i përgëzoi gjyqtarët për përkushtimin dhe punën e mirë dhe i uroi që në të ardhmen të ketë sa më shumë gjyqtarë kosovarë me stemë të FIFA-s. Ademi u shpreh se të gjithë e kanë merituar rikonfirmimin e FIFA-s dhe uroi që ata me punën e tyre të jenë shembull në rajon e më gjerë. Ndër të tjerë, i pari i FFK-së tha se me implementimin e teknologjisë VAR, gjyqtarëve u është lehtësuar puna duke u zvogëluar edhe mundësia për gabime.

Gjyqtarë kryesorë
Genc Nuza
Visar Kastrati
Besfort Kasumi

Asistentë
Lumturije Muhadri
Fatlum Berisha
Bujar Selimaj
Fatmir Sekiraga
Edmond Zeqiri
Besnik Morina
Granit Hyseni

Gjyqtarë të futbollit
Besar Beqiri
Besart Ismajli
Florentina Kallaba

Curry magjik për Golden State, humbasin Miami dhe Memphisi

HOUSTON, 1 SHKURT - Ekipi i Golden State fitoi me rezultatet 122-108 në fushën e Houston, duke qëndruar në vendin e dytë në Perëndim. Ndeshje fantastike e Stephen Curry, autor i 40 pikëve. Pas kohës shtesë fiton Philadelphia, që mposhti Memphis 122-119, një ndeshje me emocione dhe spektakolare. Maxey me 33 pikë dhe Harris me 31 pikë bënë dallimin në parket për Philadelphia, ndërsa 34 pikët e Bane për miqtë mbetën për statistikë. Humbet edhe Miami, që dorëzon



kreun në Lindje. Ekipi nga Florida u mund 122-92 nga Boston, me

REZULTATET	
Cleveland - New Orleans	93-90
Indiana - Clippers	122-116
Philadelphia - Memphis	122-119
Atlanta - Toronto	100-106
Boston - Miami	122-92
New York - Sacramento	116-96
Houston - Golden State	108-122
Oklahoma - Portland	98-81

Brown protagonist, autor i 29 pikëve.

Ish-trajneri i Chelseat, Avram Grant, akuzohet për ngacmim seksual

Ish-trajneri i Chelseas, Avram Grant, po akuzohet për ngacmim seksual të disa grave, sipas një hetimi të televizionit izraelit "Channel 12". Ky televizion transmetoi një seri të gjatë dëshmish kundër ish-trajnerit të

Chelseat. Femrat e intervistuar akuzuan Grant se u përpoq nga pozicioni i tij për t'i bindur ato të kishin marrëdhënie seksuale, sepse do t'i ndihmonte më pas në karrierë. Një vajzë 22-vjeçare, siç raporton gazeta "The

Times of Israel", deklaroi se ishte ftuar nga trajneri në banesën e tij, ku edhe kishin ndodhur ngacmimet seksuale. Strategu i futbollit nuk i ka mohuar akuzat, duke u shprehur se nuk ka bërë asgjë të qëllimshme: "Në jetën

time jam përpjekur gjithmonë të respektoj çdo grua dhe çdo burrë. Gjithmonë jam përpjekur t'i trajtoj gratë me respekt dhe miqësi, kurrë nuk kam synuar të sillem në mënyrë të padrejtë ose ta dëmtoj ndonjërin në asnjë

mënyrë. U ndjeva në siklet për shkakun tim. Kërkoj falje nga thellësia e zemrës sime", ka shtuar më tej ai. Duket se Granti mund të vuajë edhe dënimin me burg, nëse akuzat për ngacmim seksual vërtetohen.

SHKURT

Adriano: Interi mund ta fitojë Ligën e Kampionëve

"Interi i ka të gjitha mundësitë për ta fituar titullin, por tani duhet të përqendrohet në derbi. Është një ndeshje e vështirë dhe e një rëndësie të veçantë, ku nuk mund të thuhet se ka favoritë sepse mund të ndodhë gjithçka". Me këto fjalë e ka vlerësuar ish-sulmuesi i Interit, Adriano, derbin e së shtunës, duke shkruar edhe më tej: "Mendoj se ata që do të lënë shenjë do të jenë Lautaro dhe Sanchez, të cilët janë futbollistë shumë të fortë". Në fund "Pernadori" ka bërë një parashikim edhe për sfidën në Ligën e Kampionëve me Liverpoolin duke mos u ndalur vetëm te kjo fazë: "Mendoj se Interi ka çdo gjë për ta mposhtur Liverpoolin, me përkushtim dhe impenjim mendoj se mund të bëhen edhe kampionët e Evropës".

City zyrtarizon rinovimin e kontratës me Cancelon


Manchester City dhe Joao Cancelo janë pajtuar për zgjatjen e kontratës mes tyre, me lojtarin që ka pranuar ta firmosë kontratën për dy vjet të tjera. Në këtë mënyrë 27-vjeçarit do të qëndrojë në "Etihad Stadium" deri në verën e vitit 2027, kohë në të cilën ai do të ketë kaluar tetë vjet në klub. "Manchester City është një klub fantastik, kështu që jam jashtëzakonisht i lumtur që kam nënshkruar këtë marrëveshje të re", ka thënë Cancelo.

Sandro rezulton pozitiv me Covid

Në këtë fillim jave ka ardhur një lajm i keq për Juventusin dhe trajnerin Max Allegri. Alex Sandro ka rezultuar pozitiv me Covid-19 pas testit të së dielës. Mbrojtësi anësor ishte i grumbulluar me Brazilin dhe tash është karantinuar dhe është asimptomatik. Këtë lajm e ka bërë me dije Federata e Futbollit të Brazilit.

Ndërron jetë ish-presidenti i njohur i Palermos, Maurizio Zamparini

Një lajm i trishtë ka tronditur futbollin italian, teksa ka ndërruar jetë në moshën 80-vjeçare, Maurizio Zamparini, ish-presidenti i Palermos, por edhe Venezias. Zamparini ishte shtruar në spital për shkak të një komplikimi me zorrën e trashë, ndërsa në fund është dorëzuar dhe nuk ia ka dalë të fitojë betejën ndaj vdekjes. Ndërkaq, arritjet e Zamparinit në futbollin italian janë për t'u vlerësuar teksa pati sukses me Palermon, madje duke e dërguar klubin sicilian deri në Evropë, ndërsa zbuloi edhe lojtarë që më pas bënë histori si Cavani, Pastore, Dybala apo Amauri.



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

06-Nr- 331
Me datë 31.01.2022

Në bazë të nenit 8 të pika 1 dhe 2 Ligjit të punës Nr- 03/L-212 , kërkesës së DSHMS me nr.prot. 01-Nr-1045651 të datës 25.01.2022 dhe sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës , 01.Nr.016-5333 të datës 25.01.2022
Drejtoria shpallë këtë:

KONKURS

1. **Dy mjek/e** të praktikës së përgjithshme në QKMF-së në Suharekë.

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës :

- Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan tretmanet, medikamentet dhe aplikon masat tjera shëruuese;
- Udhëzon pacientët në bërjen e analizave bazike laboratorike dhe aplikon procedurat tjera diagnostike;
- Aranzhon bartjen e pacientëve në spital;
- Udhëzon pacientët tek specialistët mjekësor dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore;
- Pranon implimentimin e programeve shëndetësore të dizajnuara në nivele më të larta si Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna;
- Ndihmon në preventimin e sëmundjeve ngjitëse dhe çrregullimeve të ndryshme duke u këshilluar në shëndetin bazik të përgjithshëm.

Kualifikimi : Të gjithë kandidatët duhet të kenë të kryer fakultetin e Mjekësisë, drejtimi i Mjekësisë së përgjithshme.

- Orari i punës: I plot;
- Paga: H-27,H-565/1

Kohëzgjatja 6 gjast muaj punë me mundësi vazhdimi

Kandidatët që aplikojnë duhet të sjellin këto dokumente;

- Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer;
- Vërtetimin mbi stazhin e kryer;
- Licencën e punës;
- Çertifikatën e lindjes;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën e gjendjes shëndetësore.
- Çertifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrin pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Suharekë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.



NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se “Xhavit A. Shala” Liridoni B.I. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810492231 Vushtrri dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Xhavit A. Shala” Liridoni B.I. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810492231 Vushtrri, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Xhavit A. Shala” Liridoni B.I. has come to the decision to quit its business: 810492231 Vushtrri, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit

06. Br.

Datum:

Na osnovu člana 8. stavova 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, Zahteva DZSZ Br. pr.01.- br. 01-1045651 datum 25.01.2022 i ovlašćenja Predsednika Opštine, 01-Br.016-5333 dana 25.01.2022, Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu objavljuje:

KONKURS

1. **Dva lekara** opšte prakse C

Opis poslova i radnih obaveza:

- Stara se o zdravlju, opisuje tretmane, lekove, i preuzima ostale mere za zdravstvenu negu pacijenata;
- Upućuje pacijente na osnovu laboratorijske analize i primenjuje ostale dijagnostičke procedure;
- Organizuje prenos pacijenata u bolnicu;
- Upućuje pacijente kod lekara specijaliste i razmenjuje relevantne medicinske podatke;
- Prihvata sprovođenje zdravstvenih programa sastavljenih na višim nivoima, kao Ministarstvo Zdravlja i Opštine;
- Pomaze u prevenciji zarazne bolesti i razne poremećaje u skladu sa osnovama opšteg zdravstvenog stanja itd.

- **Kvalifikacije:** Svi kandidati moraju imati završen Medicinski Fakultet – smer Opšte Prakse;

- Puno radno vreme;

- Plata : H-27,H-565/1

- Trajanje ugovora : 6 meseci probno sa mogućnosti produženja.

- **Kandidati koji konkurišu moraju doneti sledeću dokumentaciju :**

- Diplomu o stručnom obrazovanju;
- Potvrdu da je završio/la praksu;
- Licencu za rad;
- Izvod rođenih;
- Fotokopiju lične karte
- Uverenje o zdravstvenom stanju
- Potvrdu da protiv njega/ nje nije pokrenuta istraga.

Nepotpune prijave po uslovima konkursa i one koje su prispale po isteku roka, neće biti razmatrane.

Opština Suva Reka pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova, i rado očekuje aplikacije muških i ženskih osoba svih zajednica koje žive na Kosovu.

Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj Direkciji za Zdravstvo u Suvoj Reci.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnik sredstvima javnog informisanja.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Haxhi Pireci shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Halit Ramadani shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Besmir Selmani shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Aida Jonuzi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shm Medreseja Alaudin Prishtine.

► Besim Lima Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022 me nr. 2537 të datës 10.12.2021, Ndryshimit të Planit vjetor të rekrutimit për vitin 2022 me nr. 93 të datës 27.01.2022, nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 27.2, dhe 33 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr. 105 të datës 01 shkurt 2022 për plotësimin e vendeve të lira të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës:	AJAFP/ZKA/05-02/22
Grada:	ZKA-A8
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia, që t'i mundësojë UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e Auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoj njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregoj gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregon integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkojnë nga UE dhe DD i/e tij.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë publike;
- Certifikatë në njërin nga skemat e certifikimit si teknik kontabiliteti dhe asistent-auditor i sektorit publik.

2. Pozita:	Zyrtar për dizajnim të raporteve dhe publikime
Numri i referencës:	ZDRP/ZKA/06-02/22
Grada:	ZKA-B6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimi i dizajneve dhe punëve të tjera grafike/vizuale për krijimin e identitetit, konceptit dhe përquarjes së mesazhit apo simbolikës së raporteve të auditimit sipas përmbajtjes së tyre.
- Përgatit të gjitha projektet e dizajnit, që nga konceptimi deri te shpërndarja;
- Përcakton imazhet, fontet dhe formatet duke përdorur softuerin e dizajnit grafik;
- Hulumton ide për të paraqitur koncepte dhe për të reklamuar produktet / shërbimet në rrjetet sociale, webfaqe, televizione, gazeta etj;
- Përdor teknikat e tipografisë;
- Krijon versione të ndryshme të dizajneve, logove, koncepte për broshura, prezantime, flyer-a, fletpalosje etj;
- Asiston me realizimin dhe përgatitjen e videove dhe fotografive;
- Kryen edhe detyra të tjera, të ndërlidhura me dizajnin grafik dhe që paraqiten sipas nevojave dhe rasteve të caktuara.
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti në fushën e dizajnit grafik ose të ngjashme;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha përkatëse.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 02.02.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17.02.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënime:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu, br. 2537 datuma 10.12.2021 i Izmenu Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu br. 93 datuma 27.01.2022, članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 27.2, 33 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 105 datuma 01.02.2021 za popunjavanje slobodnih radnih mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. Položaj:	Junior Revizor za finansijsku reviziju i reviziju uskladenosti;
Broj reference:	AJAFP/ZKA/05-02/22
Nivo:	ZKA-A8
Broj radnih mesta:	Dva (2)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarne informacije o revizijama u kojima se angažuje, u pripremi revizorskih dosjea i obavlja druge poslove vezanih za reviziju;
- Jasno pisanje u popunjavanju revizorskih radnih dokumenata o adresiranju pitanja i u skladu sa standardima NKR-a i njihovo blagovremeno dostavljanje VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata o temama (uzorcima) i revidiranim oblastima i svih dokumenata (uključujući one primljene od subjekata) koje treba da budu u skladu sa formatom i zahtevima navedenim u metodologiji, kako bi se VT-u omogućila lakša revizija;
- Blagovremeno popunjavanje radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a da bi se postigli rokovi koje je odobrio menadžment;
- Pruža saradnju i tačne informacije Timu za reviziju, njegovom departmanu i svim drugim sektorima i departmanima u okviru NKR-a;
- Pomaže drugom osoblju tima i departmana, oko revizorskog rada, za korišćenje informacionih tehnologija, pruža podršku VT-u i odgovoran je u sprovođenju zadatka za postizanje objektiviteta tima i departmana;
- Dobra komunikacija sa članovima tima sa osobljem VT-em, DD-em, NKR-om i osobljem subjekata tokom revizije;
- Održavati i ažurirati stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-em i DD-em tokom procene učinka za prethodnu godinu, kao i za pohađanje obuka koje organizuje NKR u vezi sa kontinuiranim profesionalnim usavršavanjem i obrazovanjem;
- Pokazuje visok integritet i poštuje Kodeks etike i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje se mogu zahtevati od VT-a i DD-a.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijama ili javnoj upravi;
- Sertifikat u jednoj od šema sertifikacije kao računovodstveni tehničar i pomoćnik-revizor u javnom sektoru.

2. Položaj:	Službenik za dizajniranje izveštaja i publikacija
Broj reference:	ZDRP/ZKA/06-02/22
Nivo:	ZKA-B6
Broj radnih mesta:	Jedno (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Izrada dizajna i drugih grafičkih/vizuelnih radova za kreiranje identiteta, koncepta i prenoša poruke ili simbolike revizorskih izveštaja prema njihovom sadržaju.
- Priprema projekte dizajna, od ideje do distribucije;
- Definiše slike, fontove i formate pomoću softvera za grafički dizajn;
- Istražuje ideje za predstavljanje koncepta i reklamiranje proizvoda/usluga na društvenim mrežama, veb stranicama, televiziji, novinama, itd.;
- Koristi tehnike tipografije;
- Kreira različite verzije dizajna, logotipa, koncepta za brošure, prezentacije, flajere, letke itd.;
- Pomaže u realizaciji i pripremi video zapisa i fotografija;
- Izvrši i druge zadatke, vezane za grafički dizajn i predstavljene prema specifičnim potrebama i slučajevima.
- Obavlja i druge zadatke po naređenju direktora departmana.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma u oblasti grafičkog dizajna ili slično;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna je sertifikacija iz relevantne oblasti

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 02.02.2022.godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 17.02.2022.godine do 16.00 časova.

Obrazi za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručnju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

